



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK
VENDIM**

Nr. 56 datë 29.12.2023

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”**

Në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 të miratuar më datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 date “ Per financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar , ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar ,ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar , udhezimit nr. 23 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te pergatitjes se programit Buxhetor Afatmesem të njesive të qeverisjes vendore” të ndryshuar, udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar këshilli bashkiak Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I:

1. Miratimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 33 vota
Vota Pro 33
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 4.1.2024

Kalendari PBA & buxhetit vjetor

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë;
- Hyn në fuqi dhe shpërmdahet te të gjitha njësitë shpenzuese nga kryetari i njësisë (Janar .2024).

Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe penzimeve

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2024);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2024).

Tavanet e shpenzimeve të PBA në nivel programi

- Kryetari i njësisë-proponon-tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2024);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2024);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i tavanëve);
- Udhëzimi shpërmdahet te njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve / 20.03. viti 2024);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2024);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.viti 2024);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërmdan te të gjitha njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare / 25.07. viti 2024).

Kërkesat sipas tavanëve

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përgatitore te Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill.viti t) dhe japin argumente për fonde / tavane shtesë;
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përfundimtare (1.08. viti 2024).

PBA & Buxheti vjetor

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t+1, t+2, t+3 (30.05.2024)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2024); •MFE-ja dërgon opinionion e saj mbi PBA-në te njësia vendore (20.06. viti 2024);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinion e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2024);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2024);
- Kryetari publikon PBA, / dokumentin I (5.07 viti 2024);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2024);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2024);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2024);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar te MFE-ja 15.09.2024
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2024);
- MFE-ja dërgon opionin përfundimtar sipas rastit te njësia vendore (20.10.2024);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2024);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2024);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2024).